

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

RREGULLORE E PUNËS E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË KOK

**Miratuar nga Bordi Ekzekutiv i KOK në mbledhjen e 20 të BE së KOK si dhe nga
Asambleja e Përgjithshme e KOK e mbajtur më 31.03.2023**

Neni I

Qëllimi

1. Me këtë Rregullore, përcaktohen procedurat, rregullat, kriteret dhe kompetencat e pavarura të Këshillit Mbikqyrës të KOK si dhe zbatimin e tyre në praktikë (më tutje KMK).
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të KOK dhe për personat tjerë, të cilët marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës.

Neni II

Parimet e ushtrimit të funksionimit të Komisionit të Sportit

1. Këshilli Mbikqyrës i KOK-ut, ushtron veprimtarinë e tij bazuar në Kartën Olimpikë, Statutin e KOK-ut, këtë rregullore si dhe bazuar në legjislacionet e Republikës së Kosovës të cilat rregullojnë fushat përkatëse të Këshillit;
2. Këshilli Mbikqyrës i KOK-ut në çdo rrethanë, gjatë punës së tij respekton parimet e përgjithshme të transparencës, proporcionalitetit, barazisë, paanshmërisë dhe efektivitetit.

Neni III

Themelimi dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikqyrës të KOK

1. KOK bazuar në legjislacionin e tij, në Kuvendin zgjedhor, themelon Këshillin Mbikqyrës të KOK në përbërje prej (5) pesë anëtarë, nga rradhët e propozimeve të anëtarëve të tij (federatave sportive), respektivisht propozimet e kandidaturave nuk duhet t'i përkasin rradhës së delegatëve votues në Kuvendin e KOK
2. Këshilli Mbikqyrës është organ i pavarur i KOK.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të KOK votohen nga anëtarët (delegatë) e Kuvendit të KOK, nga rradhët e të cilëve më pastaj zgjidhet Kryetari/Kryetarja dhe Nënkryetari/Nënkryetarja në pajtim me Statutin e KOK dhe këtë Rregullore.
4. Anëtarët e këtij Këshilli nuk mund të jenë edhe anëtarë të Këshillave apo komisioneve të përhershme apo të përkohshme të KOK, respektivisht nuk mund të kenë tjera funksione në kuadër të KOK.

Neni IV

Mbledhja konstituive e Këshillit Mbikqyrës të KOK

1. Në seancën e parë konstitutive, anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, nga rradhët e veta zgjedhin Kryetarin dhe Nënkryetarin e Këshillit Mbikqyrës.
2. Seancën e parë konstitutive e thërret dhe me të deri në zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkryetarit, e udhëheq Sekretari i Përgjithshëm i KOK.
3. Kandidatët për Kryetar dhe Nënkryetar zgjidhen nëpërmjet propozimit dhe votimit të të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

4. Në rast të më shumë se (1) një propozimi për Kryetar dhe Nënkryetar, i zgjedhur konsiderohet ai që ka fituar shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës si Kryetar, respektivisht Nënkryetar.
5. Mandati i Kryetarit, Nënkryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës zgjat (4) katër vjet, respektivisht një Cikël Olimpik.
6. Mandati i Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të KOK mund të ndërprehet edhe para skadimit të mandatit të tyre, në rast të:
 - Dorëheqjes së tij;
 - Në rast të vdekjes;
 - Në rast të shkarkimit të tij;
 - Me shkapërderdhjen e KOK;

Neni V

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të KOK

1. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të KOK thirren nga Sekretari i Përgjithshëm i KOK në koordinim paraprak me Kryetarin e KMK-së. Për mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës ftohen të gjithë anëtarët, ndërsa ftesa dhe prania e Sekretarit të Përgjithshëm të KOK në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të KOK është opcionale dhe varësisht nga kërkesat e KMK-së.
2. Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjet e veta nxjerr rekomandime, konkluzione si dhe përmbledhje apo raport të punës së KOK.
3. Mbledhjet e Këshillit i udhëheq Kryetari, ndërsa në mungesë të tij, udhëheq Nënkryetari i Këshillit Mbikëqyrës.
4. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të KOK mbahen të paktën (1) një herë në vit, përkatësisht sipas nevojës.
5. Në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të KOK mbahet evidencë dhe procesverbal. Procesmbajtësi zgjidhet nga rradhët e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të KOK ruhen në arkivën e KOK.
6. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të KOK, duhet të informohen për mbledhje së paku (3) tre ditë para datës së caktuar të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të KOK nga Sekretari i Përgjithshëm i KOK.
7. Prania në mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës të KOK është obligative përveç në rastet e jashtëzakonshme dhe të njohura paraprakishtë.
8. Në çdo mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës nga Kryetari verifikohet pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ku për mbajtjen e mbledhjeve duhet të ketë kuorum, ku së paku (3) tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të KOK duhet të jenë prezentë.
9. Rendin e ditës dhe materialin për mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës e përgatit Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës në konsultim, bashkëpunim dhe koordinimin me Sekretarin e Përgjithshëm të KOK, të cilin pastaj e dërgon tek anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të KOK.

- 10.** Këshilli Mbikëqyrës, është i obliguar që brenda një viti kalendarik të përpiloj raport në lidhje me punën dhe aktivitetet e KOK, i cili fillimisht duhet të miratohet dhe t'i paraqitet Bordit Ekzekutiv dhe pastaj Kuvendit të Punës së KOK.

Neni VI

Të drejtat dhe kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës të KOK

- 1.** Këshilli Mbikëqyrës i KOK ka kompetenca, të drejta, dhe përgjegjësi të listuara si më poshtë:
- a)** Mbikëqyrë Raportin e Auditorit të Jashtëm të KOK;
 - b)** Sipas nevojës, Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kërkojë vendimet e projekteve përkatëse të BE të KOK;
 - c)** Propozon tek Bordi Ekzekutiv i KOK rekomandime rreth marrjes së masave dhe veprimeve në rastet kur vlerëson se ka shkelje ligjore të akteve të miratuara nga Bordi Ekzekutiv apo Kuvendi i KOK;
 - d)** Sipas nevojës mund të shqyrtojë raportet e punës së KOK;
 - e)** Sipas nevojës mund të shqyrtojë raportet e kontrollit të përputhshmërisë së punës së KOK me rregulloret përkatëse;
 - f)** Vlerëson përputhshmërinë e planit strategjik të KOK me punën dhe aktivitetet e KOK çdo vit, për një mandat;
 - g)** Vlerëson përputhshmërinë e planit financiar të KOK të miratuar paraprakisht nga Kuvendi i Punës së KOK;
 - h)** Këshilli Mbikëqyrës i KOK për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të KOK;
 - i)** Bën punë të tjera në pajtim me Statutin e KOK si dhe këtë Rregullore;

Neni VII

Përgjegjësitë e përgjithshme të Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të KOK

- 1.** Nga Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës pritet t'i japin prioritet interesit të KOK dhe partnerëve të tij, aftësitë dhe vëmendjen e tij/saj si dhe duhet të përmbushin të gjitha detyrat e veta në një mënyrë profesionale dhe etike, të parapara me Statut të KOK si dhe me këtë Rregullore.
- 2.** Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës pajtohen se gjatë tërë kohës së mandatit të tij/saj do të shërbejnë me besnikëri, me zell dhe me përvojën e tij/saj do të ndihmoi në kryerjen e detyrave gjatë aktiviteteve të KOK.
- 3.** Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në harmoni me përgjegjësitë dhe detyrimet sipas Statutit të KOK do ti përmbahen të gjitha politikave, procedurave dhe rregullave si të shkruara ashtu edhe ato gojore të aprovuara nga KOK dhe të ndryshuara kohë pas kohe.
- 4.** Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës obligohen të kryejnë punën me kujdes dhe shkathtësi të arsyeshme;
- 5.** Të respektojnë Ligjin e aplikueshëm në Kosovë;

6. Të veprojnë me nder dhe korrektësi dhe në interesat më të mira të KOK, duke treguar besnikëri ndaj KOK-ut;
7. Të respektojnë politikat e KOK-ut të cilat miratohen me shkrim kohë pas kohe, përfshirë por pa u kufizuar në politikat për shpenzime të ndryshme, transaksionet fiskale, udhëzime dhe shpenzime, kontakte me shtypin, konfliktin e interesit, dhuratat, mbrojtjen e të dhënave etj;
8. Të respektojnë udhëzime dhe rregullore të arsyeshme të KOK dhe udhëzimet e tjera të aplikueshme në Kosovë;

Neni VIII

Mënyra e Votimit

1. Votimi sipas propozimit bëhet me ngritjen e dorës, nëse nuk vendoset që votimi të bëhet në mënyrë tjetër.
2. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës mund të votojë për, kundër, ose të abstenojë (përmbahet) nga votimi.
3. Votimi “PËR”, “KUNDËR” dhe “ABSTENIM” konstatohet në procesverbal.
4. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtë të jap mendimin ose qëndrimin e tij lidhur me propozimin që shqyrtohet, ose për të cilin votohet, të kërkojë të përfshihet në procesverbal.

Neni IX

Mënyra e Vendimarrjes

1. Këshilli Mbikëqyrës vendimet i merr me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Në rast të ndarjes së votave, vota e Kryetarit dhe në mungesë të tij, vota e Nënkryetarit, vendosë.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e lëshojnë mbledhjen dhe nuk marrin pjesë në miratimin e vendimeve nëse është vënë në pikëpyetje objektiviteti i tyre, për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesit.
3. Këshilli Mbikëqyrës mund të vendosë dhe miratojë vendime edhe pa mbajtur mbledhje, nëse të gjithë anëtarët japin pëlqim me shkrim ndaj propozim/vendimit, i cili miratohet. Pëlqimi mund të jepet me nënshkrim-dora vetë, apo me nënshkrim të dërguar në mënyrë elektronike për projekt-vendimin.
4. Vendimet e miratuara me pëlqim me shkrim të anëtarëve hyjnë në fuqi në ditën e dhënies së pëlqimit nga të gjithë anëtarët.

Neni X

Pagesat e Komisionit

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës do të kompensohen financiarisht për kontributin e dhënë bazuar në vendimet e Bordit Ekzekutiv të KOK.

2. Obligohet kryetari i Këshillit Mbikëqyrës që brenda afatit prej 5 ditëve pas përfundimit të mbledhjeve, të dërgojnë tek Departamenti Financiar dhe Departamenti Ligjor i KOK, raportet përkatëse të punës së Këshillit.

Neni XI

Informata Konfidenciale

1. Informata konfidenciale nënkupton informatën që ka të bëjë me të dhënat, dokumentet apo informatat tjera që nuk janë në domenin publik dhe nga KOK përcaktohet si informatë konfidenciale.
2. Informata konfidenciale për t'u konsideruar si e tillë, duhet t'i përmbush disa kritere:
 - a) informata duhet të jetë dokument i besueshëm dhe mos t'i përkas domenit publik;
 - b) zbulimi i informatës do të shkaktoje cenim të interesave;
 - c) dëmtimi i mundshëm që rrjedh nga zbulimi i informatës do të jetë më i rëndë se interesi publik;
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në qoftë se kanë qasje në informatë konfidenciale obligohen ta ruajnë atë si të tillë dhe nuk guxojnë ta përdorin si mjet shantazhi apo për ndonjë përfitim personal.
4. KOK do të përcaktoj konfidencialitetin e informatave si dhe procedurat në lidhje me zbulimin e tyre, duke u bazuar në ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Neni XII

Konflikti i Interesave

1. Asnjë anëtarë i Këshillit Mbikëqyrës nuk duhet të veproj në atë mënyrë që me veprimet apo mosveprimet e tij/saj të shkel besimin e dhënë atij apo asaj si pjesë e këtij Këshillit.
2. Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk duhet të lejoj që familja, marrëdhëniet shoqërore ose të tjera të ndikojnë në vlerësimet e tij profesional dhe të krijojnë ose lejoj të krijohej përshtypja që në të mund të ndikohet në atë drejtim.
3. Si pasojë e ndikimit dhe respektit të madh që ka insitucioni në arenën e brendshme dhe ndërkombëtare, vendimet e anëtarëve të këtij Këshillit, duhet të jenë me pavarësi dhe me paanshmëri të plotë.
4. Ai ose ajo nuk duhet të përdor, ose të vepron në mënyrë që të krijohej përshtypja e përdorimit të autoritetit dhe mundësive që krijohej për shkak të pozitës e tij ose saj, për të avancuar interesat personale ose interesat të tjerëve.
5. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të KOK nuk duhet të përdorin në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo, informacionin jopublik që ata disponojnë për shkak të detyrës, për të kryer apo për të drejtuar transaksione financiare personale, ata vetë apo nëpërmjet palëve të treta.
6. Për të mënjeluar konfliktin e interesave, ky nen vendos ndalesat si në vazhdim:
 - a) Asnjë anëtarë i Këshillit Mbikëqyrës nuk duhet të pranojë të ardhura financiare ose përfitim në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë, nga institucionet bashkëpunuese apo nga një person i tretë. Të ardhurat financiare ose përfitimi përfshijnë, por nuk janë të limituara në para të gatshme, fonde, hua, kredi ose


garancione, pasuri të patundshme, dhurata, udhëtim, qiramarrje, ose shërbime personale.

- b) Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk duhet të përdorë të ardhura monetare, qoftë drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, ose ndonjë informatë që nuk është në dispozicion për publikun që ai ose ajo e marrin gjatë ose si rezultat i detyrave zyrtare.
7. Konflikti i interesave mund të mos jetë gjithmonë i qartë dhe evident. Kur një anëtar i këtij Këshillit ka dyshim nëse një aktivitet i caktuar përbën konflikt të interesit, për veten e tij, saj ose të tjerëve, ai ose ajo duhet të konsultohet me udhëheqësin e tij ose saj.

Neni XIII

Dispozitat përfundimtare

1. Për zbatimin e kësaj Rregullore përkujdesen anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të KOK si dhe Kuvendi i Punës së KOK.
2. Stafi i KOK obligohet në asistimin dhe sigurimin e materialeve dhe dokumenteve të nevojshme për Këshillin Mbikëqyrës, sipas kërkesës së tyre.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore bëhen me procedurë të njëjtë sikurse për miratimin e saj.
4. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i KOK.



Ismet Krasniqi, President